

## AKT THEMELIMI

### I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

#### “TIRANA GROUP - AL” SHPK

Sot më datën 29 tetor 2022, unë ortaku themelues:

**Islam Gomaa**, shtetas shqipëtar, i biri i Mohamed Sobhy, lindur më 05/05/1970 në EL Shikh, Egjipt dhe banues në Tiranë me adresë: Rruga “Peti” Kopshti Zologjik, Tirane, Kompleksi Xhelili, shtetas shqipëtar i indentifikuar nga Karta e Identitetit nr. 036599629, me numer personal, ID H00505109K

Në përputhje me Ligjin nr.9901 Datë 14.04.2008, si edhe Ligjin nr.9723 date 3.5.2007, nenet 26,28,32 e 35 ”Për Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit “,

Kam vendosur të themelojnë *Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar “TIRANA GROUP - AL “ Shpk*

#### *Neni 1.*

#### **EMERTIMI I SHOQERISE**

Shoqëria do të quhet “**TIRANA GROUP - AL” SHPK.**

#### *Neni 2*

#### **SELIA E SHOQERISE**

Selia e shoqërisë është në adresën: Lagjen “15 Tetori”, Rruga “Ndrek Papa” Z.K 8533, Pasuria nr.7/157, Fier. Shoqëria mund të hapë filial të tjera në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

#### *Neni 3*

#### **OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE**


*Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë :*

- Ndërmjetësim shkollimi brenda dhe jashte vendit,.
- Ndërmjetësim punësimi brenda dhe jashte vendit
- Ndërmjetësim për veprimtari të ndryshme tregtare, trajnime të ndryshme, organizim eventesh për vete dhe per te trete

#### *Neni 4*

#### **KAPITALI THEMELTAR I SHOQERISE**

Kapitali themeltar i shoqerise “ **TIRANA GROUP - AL**” SHPK është 100(njëqindë) lekë.  
Ky kapital është i ndarë në 1 pjesë, e cila ka vlerë nominale 100(njëqindë) lekë lekë



Kontributi i ortakut është i ndare si vijon:

**Ortaku themelues Islam Gomaa: zotëron 1 kuot baraz me 100 % të kapitalit.**

Kontributi i ortakut të vetëm themelues depozitohet në njëren prej bankave të nivelit të dytë në Shqipëri dhe dokumenti i bankar i depozitimit mbetet si pjesë akteve të themelimit.

#### *Neni 5*

### **KOHEZGJATJA E SHOQERISE**

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj për një periudhë kohe mbi 10 vjet.

#### *Neni 6*

### **ADMINISTRIMI I SHOQERISE**

Administrator i shoqërisë do të jetë **z. Islam Gomaa**, i cili emërohet për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë ripërtëritje.

Një Administrator tjetër mund të emërohet dhe shkarkohet me vendim të ortakut të vetëm, që përfaqëson njëqindpërqind të pjesëve të kapitalit themeltar. Administratori ka të gjithë kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretë në emër të shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep ortakëve.

Administratori mund të kryej të gjitha veprimet e administrimit në interes të shoqërisë.

Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë ose të tretëve përshkelje të ligjeve, statutit apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

#### *Neni 7*

### **VENDIMET E ORTAKUT TE VETEM**


Ortaku i vetëm i cili zotëron njëqind për qind të kuotave merr vendime të cilat janë të vlefshme sipas pikës 3 të nenit 81 të ligjit “Për shoqëritë Tregtare”.

Të gjitha vendimet e marra nga ortakut i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme.

Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.



*Neni 8*

**NDARJA E FITIMEVE**

Fitimi që do të shpërndahet përbëhet nga fitimi i vitit financiar, të cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjanë për rezervën, si dhe duke i shtuar apo zbritur respektivisht humbjet e mbartura nga vitet e mëparshme.

*Neni 9*

**LIKUIDIMI**

Shoqëria është në likuidim e sipër që në momentin e prishjes së saj, operacion i cili do të kryhet sipas kërkesave të parashikuara në legjislacionin tregëtar shqipëtar.

*Neni 10*

**MOSMARREVESHJET**

Mosmarreveshjet zgjidhen me mirëkuptim, në rast të kundërt, ortaku themelues do ti drejtohet Gjykatës së Rrethit për zgjidhje.

**SHOQËRIA ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**“TIRANA GROUP - AL ” SHPK**

**ORTAKU I VETEM**

**ISLAM GOMAA**

*Islam Gomma*  
